



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punijena / Prodato Received / Delivered	21.06	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSHUK	4865	2023	116	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.720/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Percuku Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.720/2023 të datës 11.05.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.720/2023 e datës 11.05.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Anullohet Konkursi me numër reference RN00010631, për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore-Asistent Ekzekutiv në Ministrinë e Ekonomisë*, i shpallur me datë 16.12.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e pranimit.
- III. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 11.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, lidhur me procesin e vlerësimit nga Komisioni i Pranimit për pozitën “Asistent

Ekzekutiv'' në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë, sipas konkursit të datës 16.12.2022, me numër referencë RN00010631, të shpallur nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore se për pozitën në fjalë në ditën e testimit me shkrim nuk ka qenë kandidatja F.B e që në rezultatet përfundimtare ka qenë si kandidatja me pikët më së shumti në testimin me shkrim, e njëjta pretendon se disa nga kandidatët në këtë proces nuk e kanë pasur kualifikimin e duhur dhe nuk kanë pasur dëshmi të përvojës së punës, si dhe me rastin e vlerësimit nga intervista me gojë kandidatët e pranuar janë vlerësuar më shumë se kjo e fundit vetëm që të avancohen në pikët përfundimtare dhe të dalin në listat e pranimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 16.05.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datën 19.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4180/2023 të datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Librezën e verbërisë së ankueses të datës 20.06.2019; Vendimin e datës 16.01.2018 nga Udhëheqësi i Divizionit të Skemave në MPMS; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 19.05.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 16.12.2022 me numër të referencës RN00010631; Vendimin me Nr.528/2023 të datës 05.04.2023 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve nga komisioni i pranimit; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Listën e ngushtë të datës 01.02.2023 nga DMZP-ja; Njoftimin e datës 10.02.2023 për plotësimin listës së ngushtë nga DMZP-ja; Njoftimin e datës 07.04.2023 lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues nga DMZP-ja; E-mailin zyrtar të datës 06.04.2023 nga kryesuesja e komisionit për Drejtorin e Departamentit Ligjor dhe Ud. Udhëheqësen e Personelit në DMZP lidhur me rezultatet përfundimtare; Listën mbi renditjen përfundimtare të kandidateve me Nr.528 të datës 06.06.2023 nga anëtarët e komisioni e gjeneruar tek SIMBNJ; E-mailin zyrtar të datës 19.04.2023 nga kryesuesja e komisioni për anëtarët e komisionit, Drejtorin e Departamentit Ligjor dhe Ud. Udhëheqësen e Personelit në DMZP lidhur me vendimin e komisionit të pranimit; E-mailin zyrtar të datës 13.04.2023 nga Ud. Udhëheqësja e Personelit në DMZP për Drejtorin e Departamentit Ligjor dhe kryesuesen e komisionit në DMZP lidhur me njoftimin për parashtrimin e ankesës së ankueses tek komisioni; E-mailin zyrtar të datës 12.04.2023 nga ankuesja lidhur me njoftimin për parashtrimin e ankesës tek komisioni; E-mailin zyrtar të datës 07.04.2023 nga DMZP lidhur me njoftimin për ankuesen që e njëjta është në listën fituese (listën në pritjes); Vendimin me Nr.631/2023 të datës 18.04.2023 nga Komisioni i Pranimit lidhur me refuzimin e ankesës së ankueses; Rezultatet e testit me shkrim të gjeneruara tek SIMBNJ; Aplikacionin e ankueses të datës 09.01.2023 së bashku me dokumentet e bashkangjitura dhe atë: Diplomën e ankueses me Nr.744/17 të datës 10.07.2017 e lëshuar nga Kolegji AAB; Diplomën e ankueses me Nr.361/22 të datës 09.03.2022 nga Kolegji AAB; Certifikatën e ankueses të datës 20.10.2028 nga FOL-Akademi e Komunikimit; Aneks marrëveshjen me Nr.110-53512 të datës 01.07.2016 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Ud. Sekretares së Përgjithshme të MAPL-

së; Kontratën me marrëveshje të veçantë të shërbimit me numër 1/2017 të datës 01.02.2017 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së; Kontratën me marrëveshje të veçantë të shërbimit me numër 2/2017 të datës 31.07.2017 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së; Kontratën me marrëveshje të veçantë të shërbimit me numër 1/2018 të datës 02.05.2018 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së; Kontratën me marrëveshje të veçantë të shërbimit me numër 2/2018 të datës 01.08.2018 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së; Kontratën me marrëveshje të veçantë të shërbimit me numër 2/2018 të datës 01.11.2018 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së; Kontratën me marrëveshje të veçantë të shërbimit me numër 1/2019 të datës 01.04.2019 e lidhur ndërmjet ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së si dhe Certifikatën e ankueses nga Austrian Development Cooperation-UN Women të muajit mars 2020.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (me tej DMZP), me datë 16.12.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00010631, për emrin e grupit "*Specialistë të Shkencave Shoqërore-Asistent Ekzekutiv në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë*", klasa profesional 3, një pozitë pune. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 06.01.2023 deri me datë 20.01.2023.

Sipas listës së aplikacioneve, në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e këtij procesi rekrutues dhe se e njëjta bazuar në vlerësimin përfundimtar të Komisionit të Pranimit është vlerësuar më gjithsej 76.6 pikë. E pakënaqur me këtë vlerësim ankuesja parashtron ankesë të Komisioni i Pranimit në DMZP, ndërsa ky i fundit me vendimin Nr.631/2023 të datës 18.04.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore referuar procedurës dhe kushteve të pranimit të nëpunësve civilë, përkatësisht:

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, nenin 6 ku përcaktohet se: "*Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve; dhe nenin 34 ku përcaktohet se: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme..... Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitën e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së*

konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi.12. Komisioni i pranimit përbëhet nga të paktën 5 persona, me këtë përbërje: një (1) përfaqësues nga Njësia përgjegjëse; tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm apo të ulët, drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi, dhe një (1) ekspert i jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara apo universitetet.

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 9 ku përcaktohet se: "1.Shpallja e një procedure konkurrimi publikohet nga Njësia Përgjegjëse në uebfaqen unike të procedurave të konkurimit dhe emërimit, pjesë e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejme: "SIMBNJ"). 2.Përveçse përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, shpallja e konkurimit publikohet, sipas rastit edhe në: 2.1. ueb faqen e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, për konkurimet për pranimin në shërbimin civil në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe në uebfaqet e secilit institucion të administratës shtetërore si vegëz e veçantë e ndërlidhur me SIMBNJ apo në; 2.2. ueb faqen e Institucionit Tjetër Shtetëror për konkurimet për pranimin në këto institucione...", nenin 15 ku përcaktohet se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve..." Neni 18 ka paraparë se : "Për konkurimin në një Institucion Tjetër Shtetëror, institucioni themelon një Komision Pranimi për të gjitha Grupet për të cilat zhvillohet konkurimi. 2.Komisioni i Pranimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin; 2.2. tre (3) anëtarë nga nëpunësit civilë të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues që ushtrojnë detyrën në pozita punë të specializuara lidhur me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive për të cilat kryhet vlerësimi i kandidatëve; 2.3. një (1) ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore, nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës... 6. Paragrafët 4 dhe 6 të nenit 17 të kësaj Rregulloreje, zbatohen përshtatshmërisht dhe në këtë rast.

Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku me nenin 33 theksohet se : Klasat përbërëse të kategorisë Profesionale, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1-Zyrtar i lartë; Profesional 2 - Zyrtar i mesëm; Profesional 3 -Zyrtar, Profesional 4-Zyrtar Administrativ; ndërsa me Shtojcën Nr.1/9 si kërkesa të përgjithshme formale për klasën Profesional 3 janë përcaktuar: a) *Arsimimi i kërkuar*: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) *Kualifikime të posaçme formale*: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) *Përvoja e punës e kërkuar*: Nuk kërkohet. Kurse sipas Shtojcës Nr. 2 për Gr. Specialistë të Shkencave Shoqërore kod nr. 14, si fusha të arsimit janë përcaktuar *Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, e te tjera të ngjashme.*

Në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar Konkursin me numër reference RN00010631, për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore-Asistent Ekzekutiv në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë*, ku si kritere të përgjithshme formale janë

përcaktuar: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, në drejtimet Ekonomi, Juridik dhe Administratë Publike; Përvoja e punës së kërkuar: nuk kërkohet dhe Dëshminë se është person me aftësi të kufizuara,* dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se kriteret e vendosura në konkursin në fjalë janë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi në kohën kur është shpallur konkursi në fjalë. Rrjedhimisht tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 14 të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, me ç' rast për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore fusha e kërkuar e arsimit është ajo **Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të tjera të ngjashme,** ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas Konkursit me numër reference RN0001063, për fushën e caktuar të arsimit janë përfshirë vetëm drejtimet nga fusha e **Ekonomikut, Juridikut dhe Administratës Publike,** andaj, mbi bazën e këtyre fakteve Kolegji i Këshillit konstaton së DMZP-ja me rastin e mos përfshirjes së fushës së arsimit të drejtimit Sociologji, Antropologji, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të ngjashme në Konkursin me numër reference RN00010631, për emrin e grupit " *Specialistë të Shkencave Shoqërore-Asistent Ekzekutiv në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë,* ka vepruar në kundërshtim me dispozita materiale si me sipër.


Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstaton faktin së meqenëse Konkursi me numër reference RN00010631 për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore-Asistent Ekzekutiv në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë*" i referohet pranimit të kandidatëve si persona më aftësi të kufizuar, atëherë edhe kërkesat e përgjithshme për pranim duhet të jenë në pajtim me kërkesat e përgjithshme formale, rrjedhimisht kërkesat e përgjithshme të pranimit duhet të përshtaten me aftësitë punuese të kësaj kategorie. Ne këtë kontekst, në pikën 2 të Konkursit në fjalë si kërkesa janë vendosur ndër të tjera edhe: *"..Të këtë zotësi të plotë për të vepruar... te jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse..."* ndërsa në pikën 4 të Konkursit është kërkuar dëshmi së kandidati për pranim është person më aftësi të kufizuar, kërkesa këto që janë në kundërshtim me njëra tjetrën.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas konstatimit së shpallja e konkursit për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore-Asistent Ekzekutiv në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë* është përfshirë me shkelje ligjore, vlerësoi që të anulohet Konkursin me numër reference RN00010631 dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga kjo procedurë pranimi, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture dhe rrjedhimisht Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.720/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.